



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:282474
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05652635

P.nr.75/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektivin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Veri), Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurve; F.O dhe Xh.B të akuzuar për veprën penale; Grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (me tej KPRK). Sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.275/2014 të datës 27.04.2015 dhe 07.03.2017. Duke vendosur sipas kundërshtimeve të paraqitura nga mbrojtësit e të pandehurve F.O dhe Xh.B, përmes avokateve mbrojtës, av.Shyqyri Sylja dhe av.Gani Rexha, të parashtruar me kërkesë për Hedhje të aktakuzës. Jashtë seancës dhe në mbështetje të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Kodit të Procedurës Penale (me tej KPP), më datën 03.05.2024, Gjykata nxjerr dhe lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHEN të bazuara Kundërshtimet e paraqitura nga mbrojtësi i të pandehurit F.O, av.Shyqyri Sylja dhe mbrojtësi i të pandehurit Xh.B, av.Gani Rexha;
- II. HEDHET - akuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.275/2014 e datës 27.04.2015 dhe 07.03.2017 dhe PUSHOHET procedura penale për veprën penale; Grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndaj të pandehurve;
 1. F.O me nofkën "F....." nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë në M....., më vendbanim në lagjen Sh..... në rrugën ".....", me numër personal të ID:.....

2. Xh.B me nofkën “Xh.....”, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë në M....., tani me vendbanim në rrugën “.....”, mbi U.... e Gj.....në M....., me numër personal të ID:.....
- III. SHPALLET provë e papranueshme Deklaratat e dëshmitarit B.P të cilën e ka dhënë më dt.20.01.2015 në Prokurorin Themelore në Mitrovicë. Kjo deklaratë veçohet nga shkresat e lëndës dhe mbahet në një zarf të mbyllur.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- V. Palët e dëmtuara R.I dhe M.H, udhëzohen që kërkesën pasurore- juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Akuza e ngritur:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.257/2014 të datës 27.04.2015 ndaj të pandehurit F.O, për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në bashkëkryerje me madhorin Xh.B dhe të miturin B.P. Ndërsa më datë 07.03.2017 ka ngritur aktakuzën tjetër PP.I.nr.257/2014, ndaj të pandehurit Xh.B për shkak të veprës penale Grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në bashkëkryerje me madhorin F.O dhe të miturin B.P.

Në këtë rast janë ngritur dy aktakuza të veçanta për shkak se i pandehuri Xh.B ka qenë në arrati, dhe në momentin që është siguruar prania e tij, prokuroria ka ngritur aktakuzën dhe e ka dorëzuar në gjykatë. Meqenëse, bëhet fjalë për një rast të vetëm, përkatësisht për një çështje penale, gjatë shqyrtimit fillestar të datës 09.02.2024, gjykata ka nxjerr aktvendim për bashkimin e çështjeve në një rast të vetëm.

- Kompetenca:

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit neni 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore

e Mitrovicës, me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra e pretenduar penale ka ndodhur në M....., dhe rrjedhimisht, bien brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1 të KPP-ës. Sipas aktakuzës së prokurorisë, vepra për të cilën akuzohen të pandehurit është: Grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e që kjo vepër penale, sipas nenit 22 parag. 1, nën parag.1.1 të KPP-së dhe nenit 19 par.1 të Ligjit për Gjykatat, bien në kompetencë të Departamentit për Krime të Rënda.

- Rrjedha e procedurës:

Më 9 shkurt 2024, Gjykata në këtë rast ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Në seancë kanë marr pjesë, prokurorja e rastit Fetije Bajrami, i pandehuri F.O dhe mbrojtësi i tij av.Shyqyri Syla, i pandehuri Xh.B dhe mbrojtësi i tij av.Gani Rexha.

Gjatë shqyrtimit fillestar të pandehuri janë njoftuar me akuzën, dëshmitë e çështjes dhe të drejtat e tyre në cilësisë të të akuzuarve. Gjykata ka vërtetuar se, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre i posedojnë të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, e që janë pjesë e kësaj dosje penale.

Gjatë shqyrtimit fillestar, të pandehurit e kanë mohuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, sipas akuzës së prokurorisë. Gjykata i 'u ka dhënë mundësi të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre që brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditë, llogaritur nga dt.10.02.2024 për paraqitjen e kundërshtimeve kundër akuzës së prokurorisë dhe provave të propozuara.

Mbrojtësi i të pandehurit F.O, av.Shyqyri Syla, më datë 27.02.2024 në këtë Gjykatë ka paraqitur kundërshtimet kundër aktakuzës me kërkesë për hedhjen e saj, sipas mbrojtësit;

- Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
- Prokuroria nuk ka deponuar asnjë dëshmi konkrete që do të vërtetonte dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale. Nuk ka prova që tregojnë qartazi se i

pandehuri është i përfshirë në këtë rast, dhe aktakuza mbështetet në supozime sesa në prova konkrete që do duhet ta dëshmonin dyshimin e bazuar.

- Në raport me të pandehurin F.O, aktakuza mbështetet vetëm në deklaratën e të bashkëpandehurve, Xh.B dhe B.P, e të cilat nuk mund të merren për bazë në kuptim të nenit 119 par.5 të KPP-së.
- Sipas dëshmive të dëmtuarave R.I dhe M.H nuk mund të vërtetohet se i pandehuri F.O ka qenë në çfarëdo mënyrë i përfshirë në këtë grabitje.
- Sipas incizimeve nga vendi i ngjarjes nuk shihet asnjë person tjetër, përveç të miturin B.P që hyn brenda në barnatore, i cili vetë e ka pranuar se ka qenë ai që ka hyrë në barnatore.
- Në fund, mbrojtësi të pandehurit F.O, av.Shyqyri Syla ka propozuar që të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit F.O.

Mbrojtësi i të pandehurit Xh.B, av.Gani Rexha, më datë 29.02.2024 në këtë Gjykatë ka paraqitur kundërshtimet kundër aktakuzës me kërkesë për hedhjen e saj, sipas mbrojtësit;

- Në bazë të provave të deponuara nuk është vërtetuar se i akuzuari Xh.B e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas dëshmive të dëshmitarëve, R.I dhe M.H nuk kanë qenë në gjendje të deklarohen rreth njohjes dhe identifikimit të të akuzuarit Xh.B.
- Sipas incizimeve nga CD në vendin e ngjarjes të siguruar nga policia nuk mund të identifikohet se cili person e ka kryer grabitjen natën kritike.
- Aktakuza bazohet në prova të papranueshme, siç është dëshmia e dëshmitarit B.P, i cili ka qenë i akuzuar se ka qenë pjesëmarrës me të akuzuarit, Xh.B dhe F.O si bashkëpjesëmarrës në kryerjen e veprës penale. Sipas mbrojtësit, kjo provë është nxjerr në mënyrë të kundërligjshme ngase një person nuk mund t'i ketë dy cilësi në procedurë penale edhe si i mitur- bashkëpjesëmarrës në kryerjen e veprës penale edhe si dëshmitar siç është vepruar nga prokuroria.
- Mbrojtësi i të pandehurit Xh.B, av.Gani Rexha ka propozuar gjykatës që të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedurën penale ndaj të pandehurit Xh.B.

Më 06 mars 2024, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur përgjigje me shkrim lidhur me kundërshtimet e ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve, F.O dhe Xh.B, av.Shyqyri Syla dhe av.Gani Rexha. Prokuroria ka propozuara që të refuzohen si të pabazuara kundërshtimet e mbrojtësve, pasi aktakuza përmban të gjitha të dhënat sipas

dispozitave të Kodit të Procedurës Penale si dhe ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat me pa mëdyshje vërtetojnë ekzistimin e veprës penale.

- Gjetjet e Gjykatës;

Kundërshtimet e paraqitura nga mbrojtësit e të pandehurve janë parashtruar brenda afatit të përcaktuar me ligj. Kundërshtimet janë parashtruar brenda afatit që lejohet sipas nenit 240 paragrafi 7 të KPP-së, afati për paraqitjen e tyre është konfirmuar edhe në seancën e shqyrtimit fillestar, ku palët janë njoftuar me të drejtën që të parashtrojnë kundërshtime brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë pas mbajtjes së seancës fillestare.

Gjykata ka gjet se kundërshtimet janë të lejueshëm dhe ka bazë për shqyrtimin e tyre. Kundërshtimet janë parashtruar sipas nenit 240 neni 7 nën par. 7.1 dhe 7.2 të KPP-ës, nga ku përcaktohet se; “jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar palët mund të paraqesin çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës”.

Gjykata gjen se kundërshtimet janë parashtruar nga personat e autorizuar sipas ligjit dhe si të tilla i plotësojnë kushtet ligjore që të shqyrtohen në themel. Neni 240 par.7 i KPP-së, përcakton shprehimisht se palët që kanë të drejtë të parashtrojnë kundërshtimet lidhur me provat dhe me kërkesën për hedhje e akuzës. Nenin 240 par. 7 të KPP-së, i cili përcakton; “Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues informon të pandehurin dhe avokatin mbrojtës që ata mund të paraqesin propozimet deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”. Kjo nënkupton se të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre në këtë fazë të procedurës penale mund të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të paraqitur kundërshtimet kundër aktakuzës dhe provave në të cilat mbështetet ajo.

Gjykata duke vlerësuar pretendimet në kundërshtimin e mbrojtësve të të pandehurve, pasi ka marrë dhe shqyrtuar përgjigjen e prokurorisë si dhe provat në tërësi, ka gjet se në këtë çështje nuk janë kontestuese faktet;

- Pretendimet e prokurorisë në aktakuzë;

Prokuroria i akuzon të pandehurit F.O dhe Xh.B, se më datë 16.10.2014 në bashkëkryerje me të miturin B.P, kanë kryer veprën penale të grabitjes në barnatoren “R..... P....” në

Mitrovicë. Sipas aktakuzës, i mituri B.P akuzohet se me përdorimin e forcës dhe kanosjes ka hyrë në barnatoren “R.... P.....” dhe i ka marr gjitha paratë nga pazari ditor, ndërsa dy të pandehurit tjerë, F.O dhe Xh.B akuzohen se në këtë rast kanë bashkëpunuar me të miturin duke bërë roje jashtë lokalit.

Sipas dëshmive të këtij rastit, rezulton se më datë 16.10.2014, në barnatoren “R.... P.....” në Mitrovicë, pronë e shtetasit N.I ka ndodhur grabitja e parave brenda lokalit. Gjithnjë sipas provave rrjedh se natën e ngjarjes një person i maskuar dhe me kaçavidën kishte hyrë në barnatoren “R.... P.....” ku prezent kanë qenë dy punëtorët, R.I dhe M.H, i cili me përdorimin e dhunës dhe kanosjes ka arrit që t’i marr gjitha paratë në shumë rreth 400-500 Euro, ndërsa, gjatë asaj kohe dy persona tjerë jashtë lokalit kanë bërë roje.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, faktet si më lart vërtetohen sipas dëshmive të dëshmitareve, R.I dhe M.H, të cilat kanë përshkruar në hollësi ngjarjen e grabitjes që ka ndodhur më 16.10.2014. Gjithashtu, sipas video-incizimeve që janë nxjerr nga hapësirat e brendshme të objektit, shihet një person që natën kritike hynë në barnatoren “R.... P.....” dhe me forcë i detyron punëtorët e barnatores R.I dhe M.H që të largohen jashtë lokalit, pastaj arrin t’i marr të gjitha paratë nga pazari ditor i punës.

Gjithashtu edhe sipas raportit mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se më 16.10.2014 në barnatoren “R.... P.....” në Mitrovicë, ka ndodhur një rast i grabitjes si dhe janë përshkruar të gjitha veprimet që janë ndërmarr në vendin e ngjarjes. Në raport me veprimet e pretenduar për të pandehurit F.O dhe Xh.B, vërejmë se në aktakuzë mungojnë shpjegimet apo arsyetimi se si prokuroria ka arrit deri te përfundimi për sa i përket përfshirjes së të pandehurve në këtë rast të grabitjes. Në faqen 3 të arsyetimit të akuzës, prokuroria pretendohet se fajësia e të pandehurve vërtetohet sipas dëshmisë së dëshmitarit B.P. Prandaj mund të konkludojme se akuzën e saj, prokuroria e mbështet në deklaratën e dëshmitarit B.P, i cili ka qenë edhe i bashkëpandehur me dy të pandehurit tjerë për të njëjtin rast të grabitjes.

Në dëshminë e tij, që ka dhënë më dt.20.01.2015, pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dëshmitari B.P, ka pranuar se së bashku me të pandehurit F.O dhe Xh.B më datën 16.10.2014, kanë kryer grabitjen e parave në barnatoren “R.... P.....” në Mitrovicë. Sipas tij,

të pandehurit F.O dhe Xh.B kanë bërë roje jashtë objektit, ndërsa ai i maskuar ka hyrë në barnatore dhe ka kryer grabitjen, ku ka arrit t'i marr një shumë të parave të cilat pastaj i ka ndarë me dy të pandehurit.

Gjykata rikujton se sipas pretendimeve të prokurorisë në këtë aktakuzë rezulton se B.P trajtohet si i bashkëpandehur në rastin e grabitjes me të pandehurit, F.O dhe Xh.B.

Gjithashtu për këtë rast të grabitjes policia kishte ushtruar kallëzimin penale më datën 07.04.2014 ndaj të pandehurve, F.O, Xh.B dhe B.P. Edhe sipas aktakuzës së prokurorisë, të pandehurit F.O, Xh.B akuzohen se në bashkëkryerje me të miturin B.P kanë kryer grabitjen në barnatoren "R.... P....." në Mitrovicë. Këto fakte dëshmojnë se B.P ka qenë i bashkëpandehur për të njëjtën çështje penale me të pandehurit, F.O dhe Xh.B.

Për më tepër, për rastin e grabitjes i mituri B.P është marr në pyetje nga policia me datën 07.11.2014, në cilësi të të pandehurit. Me pak fjalë, B.P fillimisht është pyetur si i pandehur, pastaj si dëshmitar për të njëjtën rast penal. Prandaj në këtë kontekst, deklarata apo mbrojtja e të pandehurit B.P nuk mund të shërbej si provë fajësuese për të pandehurit F.O dhe Xh.B.

Gjykata rikujton se sipas nenit 119 par.5 të Kodit të Procedurës Penal, përcaktohet se deklarata e të pandehurit nuk mund të shërbejë si provë në raport me të bashkëpandehurin tjerë, aq më tepër si provë e vetme.

- Shih paragrafin 5 të nenit 119 të KPP-së.

Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë;

"Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por ato nuk mund të shërbejnë si prova të vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit që i ka dhënë. Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçantë, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë".

Në anën tjetër, duke qenë se B.P ka qenë i bashkëpandehur sipas rregullave të parapara me këtë Kod, ai nuk mund të pyetet si dëshmitar, pavarësisht formës apo mënyrës se përfundimit të çështje penale kundër tij. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se sipas nenit 123 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, përcakton se; “si dëshmitar nuk mund të dëgjohet i bashkëpandehuri në një çështje penale të njëjtë, përveç kur i bashkëpandehuri është shpall dëshmitar bashkëpunues”. Në rastin konkret nuk ka asnjë vendim që i pandehuri B.P të jetë shpall dëshmitar bashkëpunues i prokurorisë.

- Shih nenin 123 të KPP-së.

Dëshmitarët e privilegjuar;

1. Si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje:

1.1. personi i cili me deklarimin e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, derisa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim;

1.2. mbrojtësi, për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vet, përveç kur kërkon vetë i pandehuri; dhe

1.3. i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të këtij Kodi.

Gjykata rikujton se sipas nenit 125 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, janë të përcaktuar rrethanat kur dëshmia e dëshmitarit konsiderohet provë e papranueshme. Sipas kësaj dispozite, dëshmia e dëshmitarit konsiderohet provë e papranueshme në rrethanat kur dëshmitari nuk mund të pyetet si dëshmitar. Ndërkaq, sipas nenit 123 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, përcaktohet se si dëshmitar nuk mund të merren në pyetje; “I bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të këtij Kodi”.

Gjykata rikujton se dëshmia e dëshmitarit B.P do të mund të përdorej si provë kundër të pandehurve tjerë, nëse prokuroria do ta merrte në pyetje si dëshmitar bashkëpunues. Mirëpo, prokuroria ka lëshuar një mundësi të tillë ligjore që parashihet me këtë Kodi, përkundër faktit që i pandehuri ka pranuar të bashkëpunoj, prokuroria është mjaftuar që të njëjtin ta intervistoj vetëm në cilësi të dëshmitarit, përkundër që ky veprim procedural bie ndesh me nenin 123 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të KPP-së.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 243 paragrafi 3 e lidhur me nenin 125 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 123 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, Gjykata e ka shpall provë të papranueshme deklaratën e dëshmitarit B.P, të cilin e ka dhënë më dt.20.01.2015, në Prokurorin Themelore në Mitrovicë.

Për sa i përket dëshmive të dëshmitareve, R.I dhe M.H, Gjykata vlerëson se deklaratimet e tyre provojnë disa fakte të rëndësishme për çështjen penale –veprën penale që është kryer, por që nuk dëshmojnë ndonjë fakt të rëndësishëm për identifikimin e kryerësve të kësaj vepre penale. Sipas deklaratimit të tyre, rezulton se natën kritike të ngjarjes, R.I dhe M.H kanë qenë në vendin e tyre të punës në barnatoren “R.... P.....” në Mitrovicë dhe gjatë asaj kohë një person i maskuar ka hyrë në barnatore i cili me dhunë ua ka kishte marra të gjitha paratë që posedonin. Gjithashtu, dëshmitaret kanë thënë se nga frika kanë dal jashtë lokalit dhe pastaj ishin sulmuar fizikisht nga dy persona tjerë jashtë lokalit të cilit kanë qenë duke e vëzhguar situatën nga jashtë. Kanë shtuar se, si pasojë e sulmit fizik kanë pësuar lëndime trupore që dëshmohen përmes dokumentacion përkatës mjekësor. Dy dëshmitaret i kanë përshkruar personat të përfshirë në këtë rast por nuk kanë arritur t’i identifikojnë identitetin e tyre.

Prandaj në bazë të dëshmive të dëshmitareve, R.I dhe M.H vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se ka ndodhur grabitja e parave në barnatoren “R.... P.....”, por nuk mund të vërtetohet dyshimi i bazuar se këtë vepër penale e kanë kryer të pandehurit F.O dhe Xh.B. Siç u theksua më lart, dëshmitaret në asnjë mënyrë nuk i kanë fajësuar dy të pandehurit, pasi që nuk kanë arrit t’i identifikojnë identitetin e saktë të grabitëseve, përveç se kanë bërë një përshkrim të përgjithshme të personave që i kanë parë natën kritike.

Gjykata gjithashtu i ka vlerësuar edhe dëshmitë materiale të propozuara, sipas këtyre dëshmive vërtetohen faktet në raport me ekzistimin e veprës penale, sendet që janë gjet dhe sekuestruar në vendngjarje, si dhe pasqyrimi i tyre në raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes. Asnjëra nga dëshmitë materiale nuk dëshmon ndonjë dyshimin e bazuar mirë për përfshirjen e të pandehurve në këtë rast të grabitjes.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen që kanë paraqitur të pandehurit për këtë rast. I pandehuri F.O, në deklaratën e tij që ka dhënë me datën 07.11.2014, pranon se natën e ngjarjes ka qenë së bashku me të pandehurin Xh.B dhe të miturin B.P, se kanë qëndruara së bashku

rreth dy orë dhe se kanë konsumuar narkotik. Sipas tij, pas takimit me të pandehurit është ndarë dhe ka vazhduar rrugën për në shtëpi. Gjithashtu i pandehuri pranon se gjatë takimit Xh..... dhe B..... kanë biseduar se si të sigurojnë para dhe si të kryejnë një vjedhje. Në mbrojtjen e tij, i pandehuri ka mohuar se ka marr pjesë në këtë rast të grabitjes.

Edhe i pandehuri Xh.B, në deklaratën e tij në prokurori më datë 01.03.2017, nuk e ka mohuar faktin se natën kritike ka qenë së bashku me F..... dhe B..... dhe dy persona tjerë. Sipas tij, për një kohë kanë qëndruar së bashku dhe kanë konsumuar edhe narkotik. Gjatë kohës sa kanë qëndruar bashkë, F.....dhe B..... i kanë thënë se do të shkojnë me thye një trafik, mirëpo ai nuk ka pranuar dhe është ndarë nga ta dhe ka vazhduar rrugën për në shtëpi. Sipas tij, të nesërmen është takuar me B..... dhe një shok të tij, ku të njëjtit i kanë treguar se paratë i ka marrë në barnatore. Në deklaratën e tij, ka mohuar se ka marr pjesë në këtë rast të grabitjes.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, të pandehurit në deklaratat e tyre të lartcekur nuk ka pohuar ndonjë fakt fajësues për vetveten. Të pandehurit e kanë mohuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen si dhe kanë mohuar përfshirjen e tyre në këtë rast të grabitjes. Megjithatë, në mbrojtjen e tyre të pandehurit e fajësojnë njeri tjetrin.

Në këtë drejtim, edhe njëherë Gjykata rikujton kufizimet që parashihen me nenin 119 par.5 të Kodit të Procedurës Penal, ku përcakton se: “Deklaratat e të pandehurit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si prove”. Prandaj, deklaratat e të pandehurve në raport me njeri tjetrin në asnjë mënyrë nuk mund të përdoren si provë fajësuese apo provë për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë në raport me akuzën e ngritur kundër të pandehurve.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në këtë rast prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer këtë vepër penale. Provat të cilat janë paraqitur, janë të zbehta dhe të pamjaftueshme dhe nuk provojnë dyshimin e bazuar mirë për kryerjen e kësaj vepre penale nga të pandehurit. Në anën tjetër, nuk mjaftojnë vetëm të dhënat apo indiciet për të provuar fajësinë e një personi

të akuzuar, e nevojshme dhe e domosdoshme të jetë niveli shumë i lart i të provuarit, apo thënë ndryshe duhet te provohet me prova konkret dhe të pranueshme dyshimi i bazuar mirë përmes të cilave pastaj dëshmohet fajësia e të akuzuarve.

Gjykata rikujton se prokuroria ka për obligim që sipas nenit 240 par.1 të KPP-së, të ngrit aktakuzën vetëm në rastet kur ka prova të mjaftueshme për një gjë të tillë, në të kundërtën është obligim i tyre që t'i pushoj hetimet.

Gjykata gjithashtu rikujton se, sipas nenit 47 të KPP-së, prokurori i shtetit duhet që gjatë hetimit të veprave penale të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të siguroj që një hetim të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVI të këtij kodi. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 235 të KPP-së, përcaktohet se; në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës, bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore. Në rastin konkret, prokuroria nuk ka siguruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë që do të vërtetonte se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen sipas aktakuzës.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykata në rastin konkret ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme se një veprë penale ka ndodh, sepse provat e deponuara e vërtetojnë faktin se më 16.10.2014 ka ndodhur vepra penale e grabitjes, siç përshkruhet në aktakuzë. Megjithatë, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit F.O dhe Xh.B kanë qenë të përfshirë në kryerjen e kësaj veprë penale.

Gjykata rikujton një parim shumë të rëndësishëm të procedurës penale; "In dubio pro reo", i sanksionuar me nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Sipas këtij parimi përcaktohet se; "mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij".

Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 248 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi të hedh akuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ta pushoj procedurën penale kundër të pandehurve; F.O dhe Xh.B, për veprën penale të Grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

- Kërkesa pasurore juridike;

Gjykata në përputhje me nenin 462 paragrafi 3 të KPP-së, ka vendos që palët e dëmtuara t'i udhëzoj në kontest të rregull civil për realizimin e kërkesës pasurore- juridike.

- Shpenzimet e procedurës;

Gjykata në përputhje me nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendos që të pandehurit t'i liroj nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale, duke qenë se ndaj tyre është hedh akuza dhe është pushuar procedura penale.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Renda

P.nr.75/2015, më datën 03.05.2024

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej dhjetë (10) ditë nga dita e pranimit të vendimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët.